

GJYKATA E APELIT TË KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hasan Shala kryetar i kolegjit, gjyqtarëve Gëzim Llulluni dhe Gani Avdiu, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit “KI” me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson M.G., kundër të paditurve N.I. dhe N.S., nga fshati ... Komuna Vushtrri, me bazë juridike kthimi i borxhit të kredisë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurit të parë, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, C.nr.480/2010 të datës 09.10.2013, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt. 23.03.2016 mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurit N.S. nga fshati ... K.Vushtrri, gjersa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, C.nr.480/2010 i datës 09.10.2013, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, C.nr.480/2010 të datës 09.10.2013, Obligohen të paditurit N.I. dhe N.S., nga fshati ... Komuna Vushtrri, që në emër të kthimit të kredisë, paditëses “KI” me seli në Prishtinë, t’ia paguajnë solidarisht shumën prej 1.318 euro me kamatë të kontraktuar prej 28% vjetore dhe kamatë vjetore që paguhet sipas lartësisë që aplikojnë bankat afariste në mjetet e deponuara pa destinim të caktuar për një vit, dhe atë nga data e parashtrimit të padisë 30.11.2010, e gjer në pagesën definitive të borxhit. Obligohen të paditurit që në emër të shpenzimeve procedurale t’ia paguajnë paditëses solidarisht shumën totale prej 20 euro, dhe atë në emër të taksës për padi, ndërsa në emër të shpenzimeve gjyqësore – përpilimit të këtij aktgjykimi gjykatës solidarisht t’ia paguajnë shumën prej 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë i padituri për shkak të vendimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike. Me propozim që Gjykata e Apelit ta prishë aktgjykimin e shkallës së parë dhe të njëjtin ta kthej në rishqyrtim duke e miratuar si të bazuar ankesën.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 194, të LPK-së, gjeti se:

- **Ankesa është e pabazuar** -

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja ka ushtruar padi kundër të paditurve me bazë juridike kthimi i borxhit të kredisë. Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor dhe ka nxjerrë provat si vijon: Kontratën individuale me nr. PR.03626 dt. 11.09.2007, marrëveshjet garantuese për të paditurin e dytë N.S., dt. 11.09.2007, forma identifikuese dhe ndalesa administrative e pagesës për të paditurin e dytë dhe të tretë, dëshmia e dëshmitarit B.I., N.H., pasqyra e borxhit dhe kryesit të detyrimit të dt. 22.02.2010. Andaj nga provat e cituara më lartë gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike, ashtu që vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar duke aprovuar kërkesëpadinë e paditëses si të bazuar.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parashikuara me nenin 182.2 të LPK-së, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së. Për shkak të zbatimit të rregullt të dispozitave të procedurës kontestimore dhe për shkak të hetimit të rregullt dhe të plotë të gjendjes faktike e cila nuk vihet në dyshim me asnjë pretendim ankimor, gjykata e shkallës së parë drejtë e ka aplikuar edhe të drejtën materiale. Gjithashtu janë të pabazuara pretendimet ankimore se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me shkelje qenësore. Meqenëse aktgjykimi i ankimuar nuk përmban të meta të cilat kishin me e kontestua ligjshmërinë e aktgjykimit, ngase me prova të mjaftueshme dhe me fakte vendimtare vërtetohet ligjshmëria e aktgjykimit. Dispozitivi i aktgjykimit nuk është në kundërshtim me arsyetimin dhe me prova që gjenden në shkresa të lëndës, që do të thotë se aktgjykimi i ankimuar është i qartë, preciz e konciz dhe si i tillë është dokument i përshtatshëm përmbartues. Nga të cekurat më lartë rezulton se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendos kur i ka obliguar të paditurit që në mënyrë solidare përmbushin obligimin ndaj paditëses për kthimin e kredisë. Ngase pjesëmarrësit e marrëdhënies së detyrimit kanë për detyrë ta zbatojnë detyrimin e vetë dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij. Përmbushja e detyrimit dhe pasojat e mos përmbushjes janë përcaktuar me nenin 262 të LMD-së, kur kreditori në raportin e obliguar është i autorizuar që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë me ndërjegje krejtësisht sikundër është përmbajtja e detyrimit. Kur debitori nuk përmbushë detyrimin ose vonohet me përmbushjen e detyrimit kreditori ka të drejtë të kërkojë edhe shpërblimin e dëmit që ka pësuar nga ana e debitorit. Gjersa sa i përket obligimit të pagesës në mënyrë solidare edhe për garantuesin gjykata drejtë ka vepruar ngase në bazë të dispozitave ligjore të LMD-së, kontrata mbi dorëzaninë obligohet dorëzanësi vetëm në qoftë se deklaratën mbi dorëzaninë e ka bërë me shkrim. Ky fakt vërtetohet në bazë të marrëveshjes garantuese e lidhur në mes të kreditorit dhe garantuesit N.S., e cila është e nënshkruar me dt. 11.09.2007, për çka atëherë i padituri i tretë është obliguar si dorëzani apo garantues apo sigurim personal i ekzekutimit të kontratës mbi kredinë. Kjo marrëdhënie krijohet me anë të kontratës midis kreditorit dhe dorëzanit, ku dorëzani është obliguar ndaj kreditorit se do të përmbushë detyrimin e arritur dhe të plotfuqishëm të detorit, nëse ai nuk do ta realizon kontratën mbi kredinë. Andaj pretendimet ankimore të paditurit nuk qëndrojnë ku kemi të bëjmë me obligimin e të paditurve që ta përmbushin borxhin në mënyrë solidare ngase vet fakti që është nënshkruar marrëveshja garantuese në mes të

kreditorit dhe garantuesit këtu të paditurit N.S., përmbushet akti formal juridik që i padituri N.S. të përgjigjet në mënyrë solidare për borxhin e marr nga ana e të paditurit të parë me kredi.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet tjera ankimore të cilat konsistojnë ndaj aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së dytë konsideron se këto pretendime ankimore janë të pa bazuara ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të LPK-së, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së. Gjithashtu drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale të cilën të drejtë gjykata e shkallës së dytë e vështron sipas detyrës zyrtare.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në kuptim të nenit 195.1, pika d) të LPK-së.

GJYKATA E APELIT TË KOSOVËS NË PRISHTINË
AC. nr. 3387/2013 datë 23.03.2016

KRYETARI I KOLEGJIT-GJYQTARI
Hasan Shala